



UK Health
Security
Agency

NHS



Çfarë të prisni pas vaksinimit të fëmijës suaj

KUNDËR COVID-19



Një udhëzues për prindërit e
fëmijëve të moshës 5 deri në 11 vjeç.

Zbuloni më shumë në [nhs/CovidVaccine](#)



**Shërbimi Shëndetësor
Kombëtar (NHS)
e ofron vaksinën kundër
COVID-19 për të gjithë
fëmijët e përshtatshëm.**

Kjo fletëpalosje ju tregon
se çfarë të prisni pasi
fëmija juaj ta ketë bërë
vaksinimin.

Efektet anësore

Si të gjitha barnat, edhe vaksinat mund të shkaktojnë efekte anësore. Shumica e tyre janë të lehta dhe afatshkurtra, dhe ato nuk shfaqen tek të gjithë fëmijët. Efektet anësore shumë të zakonshme duhet të zgjasin vetëm një ose dy ditë. Vaksina Pfizer ka prirje të shkaktojë më shumë efekte anësore pas dozës së dytë të vaksinës.

Efektet anësore shumë të zakonshme në ditën e parë ose të dytë përfshijnë:

- një ndjesi të dhimbshme, të rëndë dhe butësi në krahun ku është bërë injeksioni
- ndjesi lodhjeje
- dhimbje koke, dhimbje dhe të dridhura

Ata gjithashtu mund të kenë simptoma të ngjashme me gripin me episode të dridhmave dhe dridhjeve për një ose dy ditë. Megjithatë, një temperaturë e lartë mund të tregojë gjithashtu se ata kanë COVID-19 ose një infeksion tjetër.

Ata duhet të pushojnë. Ju mund t'u jepni atyre paracetamol për t'i ndihmuar ata të ndjehen më mirë. Ju lutemi, kontrolloni nëse doza dhe lloji i paracetamolit është i përshtatshëm për moshën e tyre.

Mund të gjeni më shumë informacion për paracetamolin këtu www.nhs.uk/medicines/paracetamol-for-children.

Një efekt anësor i pazakontë është ënjtja e gjëndrave në sqetull ose në qafë, në të njëjtën anë të krahut ku kanë bërë vaksinën. Kjo mund të zgjasë për rreth 10 ditë, por nëse zgjat më shumë vizitohuni te mjeku juaj.

Çfarë duhet të bëni nëse jeni të shqetësuar për simptomat e tyre?

Këto simptoma zakonisht zgjasin më pak se një javë. Nëse simptomat e tyre duket se përkeqësohen, ose nëse jeni të shqetësuar, mund të telefononi Shërbimin Shëndetësor Kombëtar (NHS) në numrin 111.

Nëse kërkon këshilla nga një mjek ose infermiere, sigurohuni që t'i tregoni për vaksinimin e tyre (tregojuni kartën e vaksinimit) në mënyrë që ata të mund ta vlerësojnë fëmijën tuaj siç duhet.

Ju gjithashtu mund t'i raportoni efektet anësore të dyshuara të vaksinave dhe ilaçeve në internet përmes [skemës së Kartës së Verdhë \(Yellow Card\)](#) ose duke shkarkuar aplikacionin e [Kartës së Verdhë \(Yellow Card\)](#).



coronavirus-yellowcard.mhra.gov.uk

A ka efekte të tjera anësore më serioze?

Kohët e fundit, raste të pezmatimit të zemrës (të quajtur miokardit ose perikardit) janë raportuar shumë rrallë pas vaksinave kundër COVID-19.

Këto raste janë vërejtur kryesisht tek meshkujt e rinj brenda pak ditësh pas vaksinimit. Shumica e këtyre njerëzve u shëruan shpejt dhe u ndjenë më mirë pas pushimit dhe trajtimeve të thjeshta.

Ju duhet të kërkonit urgjentisht këshilla mjekësore nëse fëmija juaj përjeton:

- dhimbje gjoksi
- gulçim
- ndjenjat e rrahjeve të shpejta të zemrës, fërgëllimave, ose rrahjeve të zemrës në mënyrë të përsëritur.

A mund të infektohet fëmija juaj me COVID-19 nga vaksina?

Fëmija juaj nuk mund të infektohet me COVID-19 nga vaksina, por është e mundur që të jetë infektuar me COVID-19 dhe të mos e kuptojë se i ka simptomat deri pas caktimit të vaksinimit.

Simptomat më të rëndësishme të COVID-19 janë paraqitjet e kohëve të fundit të ndonjë prej simptomave të mëposhtme:

- kollë e re e vazhdueshme
- temperaturë e lartë
- humbje ose ndryshim në shqisën e tyre normale të shijes ose nuhatjes (anosmia)

Megjithëse ethet mund të shfaqen brenda një ose dy ditësh pas vaksinimit, nëse fëmija juaj ka ndonjë simptomë tjetër të COVID-19 ose ethet i zgjasin më shumë, qëndroni në shtëpi dhe organizoni që të bëni një test.

Çfarë duhet bërë më pas?



Pas vaksinimit të fëmijës suaj, duhet t'ju jepet një kartë regjistrimi. Nëse fëmija juaj ka nevojë për një dozë të dytë, takimi i ardhshëm do të jetë

pas 8 deri 12 javëve. Doza e dytë do t'u japë atyre mbrojtje më afatgjatë.

Mbajeni të sigurt kartën e regjistrimit të fëmijës suaj. Nëse fëmija juaj ka nevojë për një dozë të dytë, mos harroni të shkoni te takimi juaj i radhës.

Nëse fëmija juaj nuk ndihet mirë për takimin e tij

Nëse fëmija juaj nuk ndihet mirë, është më mirë të prisni derisa të shërohet për t'ia bërë vaksinën.

Fëmija juaj nuk duhet të paraqitet në një takim për të bërë vaksinën, nëse është i izoluar ose në pritje të një testi për COVID-19. Në mënyrë ideale, duhet të prisni 12 javë pasi fëmija juaj të ketë pasur një test pozitiv të COVID-19, ose të paktën 4 javë nëse fëmija juaj është në rrezik më të lartë.

A do ta mbrojë vaksina fëmijën tuaj?

Vaksina kundër COVID-19 që ka bërë fëmija juaj ka treguar se zvogëlon mundësinë që ai të vuajë nga sëmundja e COVID-19.

Në mbarë botën janë dhënë miliona doza të vaksinës. Vaksina është shumë efektive tek fëmijët dhe të rinjtë.

Mund të duhen disa javë që trupi i fëmijës suaj të krijojë njëfarë mbrojtje nga vaksina. Si të gjitha ilaçet, asnjë vaksinë nuk është plotësisht efektive, kështu që duhet të vazhdoni të merrni masat e rekomanduara për të shmangur infeksionin nga fëmija juaj.

Disa fëmijë mund të sëmuren ende me COVID-19, pavarësisht se kanë bërë një vaksinë, por kjo duhet të jetë më e lehtë.

Çfarë mund të bëjë fëmija juaj pasi të ketë bërë vaksinën?

Vaksina nuk mund ta infektojë fëmijën tuaj me COVID-19 dhe ajo do të zvogëlojë mundësinë që fëmija të sëmuret.

Është ende e rëndësishme të vazhdohet të ndiqen udhëzimet aktuale kombëtare. Fëmija juaj mund të vazhdojë të shkojë në shkollë pasi ta ketë bërë vaksinën.

Për të mbrojtur veten dhe familjen, miqtë dhe kolegët tuaj, ju ende duhet të:

- mendoni për distancimin social
- vishni një maskë për fytyrën, aty ku këshillohet
- lani duart me kujdes dhe shpesh
- hapni dritaret për të lejuar brenda ajrin e pastër
- ndiqni udhëzimet aktuale
(gov.uk/coronavirus)



Si përhapet COVID-19?

COVID-19 përhapet përmes spërklave të nxjerra nga hunda ose nga goja, veçanërisht kur flisni ose kolliteni. Mund të merret gjithashtu duke prekur sytë, hundën dhe gojën pas kontaktit me objekte dhe sipërfaqe të ndotura.

Informacione të mëtejshme

Ju lutemi, lexoni broshurën e informacionit të produktit për më shumë detaje mbi vaksinën, duke përfshirë efektet anësore të mundshme, në faqen e internetit të Kartës së Verdhë të Coronavirusit (Coronavirus Yellow Card).

Ju mund t'i raportoni gjithashtu efektet anësore të dyshuara në të njëjtën faqe interneti, ose duke shkarkuar aplikacionin e Kartës së Verdhë (Yellow Card). Informacione të mëtejshme janë të disponueshme në www.nhs.uk/conditions/coronavirus-covid-19/coronavirus-vaccination.



© Crown copyright 2022. V1 1p 500K JAN 2022 (APS)
UK Health Security Agency gateway number: 20211170.
Product code: C22W511AL Albanian.

This leaflet is also available as an Easy Read version, braille, large print, and in Albanian, Arabic, Bengali, Bulgarian, Chinese, Estonian, Greek, Gujarati, Hindi, Panjabi, Latvian, Lithuanian, Polish, Portuguese, Brazilian, Romany, Romanian, Russian, Somali, Spanish, Turkish, Twi, Ukrainian and Urdu paper copies.

Për të porositur më shumë kopje të kësaj fletëpalosje, vizitoni www.healthpublications.gov.uk ose telefononi: 0300 123 1002 (nga ora 8.00 e mëngjesit deri në orën 18.00 të mbrëmjes, nga e hëna deri të premten).